
	<p><b>Republika e Kosovës</b>  <b>Republika Kosova - Republic of Kosovo</b></p> <p><b>Komuna e Prishtinës</b>  <b>Opština Priština -Municipality of Prishtina</b></p>	
---	---	---

<b>Datë/a:</b>	10.08.2016
<b>Referenc-ë:</b>	01-561
<b>Për/ Za/ To:</b>	<b>Kryetarin e Komunës, z. Shpend Ahmeti</b> <b>Drejtorin e Administratës, z. Muhedin Nushi</b>
<b>Përmes/Preko/Through:</b>	Qendra për Shërbim me Qytetarë
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	Raport gjashtë-mujor, Janar-Qershor 2016

## Raport Gjashtë-Mujor

### 1. Hyrje

Mandati i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim shtrihet në parimet kryesore të referuara në Rregulloren 02/2010. Zyra identifikon, promovon dhe përkrahë politikat, aktivitetet dhe programet përkatëse për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve. Qasja e barabartë e komuniteteve në shërbimet publike përbën një aspekt të fushë-veprimtarisë së Zyrës. Kthimi i qëndrueshëm i personave të zhvendosur dhe atyre të riatdhesuar është në kuadër kompetencave të azhurnuara Zyrës.

Pikat kryesore në të cilat do të fokusohet ky raport gjashtë-mujor janë: vështrimi i përgjithshëm i komuniteteve në komunë, bazuar në të drejtat e komuniteteve; projektet infrastrukturore; projekte tjera; riintegrimi i personave të riatdhesuar; takimet koordinuese/konsultuese me organet relevante dhe organizatat ndërkombëtare; dhe çështje të tjera që ndërlidhen me parimet e përgjithshme të funksionimit të Zyrës.

## 2. Vështrim i përgjithshëm i komuniteteve

Qasja e komuniteteve jo-shumicë në shërbimet publike gjatë këtyre gjashtë muajve është e drejtë dhe e kënaqshme në të gjitha organet komunale. Të drejtat e komuniteteve respektohen konform infrastrukturës ligjore dhe kushtetuese. Kërkesat e tyre shqyrtohen konform dispozitave ligjore, pa diskriminuar pjesëtarët e komuniteteve bazuar në përkatësi etnike, religjion dhe gjini.

Qasja e komuniteteve jo-shumicë në regjistrin civil është e kënaqshme dhe në këtë drejtim Komuna e Prishtinës ka marrë vendim për muajin falas në regjistrin civil për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas. Prej datës 15 Qershor 2016 deri më 31 Korrik 2016 anëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas kanë nxjerrë 124 dokumente të regjistrit civil falas në Komunën e Prishtinës. Zyra për Komunitete dhe Kthim ka shpërndarë njoftimet për lansimin e kësaj fushate.

Gjatë këtij gjashtë mujori gjendja e sigurisë është e kënaqshme dhe nuk ka pasur incidente të natyrës etnike, duke u bazuar në raportimet e Policisë së Kosovës në KKSB. Për çdo ankesë anëtarët e komuniteteve joshumicë raportojnë në stacionin më të afërt policor, të cilat raportohen në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Prishtinës.

Qasja në shëndetësi dhe mirëqenie sociale është e kënaqshme. Sikurse vitin e kaluar edhe këtë vit kemi vizituar qendrën më të afërt shëndetësore për anëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas është në lagjen „Tophane“. Sipas përgjegjësve të kësaj qendre shumica e pacientëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas që vizitohen në këtë ambulant marrin asistencë sociale dhe janë të liruar nga pagesat për shërbime shëndetësore që i'u ofrohen. Të liruar nga pagesat gjithashtu janë: gratë shtatzëna, studentët, veteranët e luftës, pensionistët etj. Kjo Qendër e Mjekësisë Familjare vazhdimisht mbanë fletushka me informacione rreth mirëmbajtjes së higjienës së duarve dhe trupit, si dhe ofrimit të shërbimeve mjekësore. Informata të tilla kanë edhe qendrat e tjera shëndetësore për të gjithë qytetarët, pa asnjë dallim.

Nëngrupi Punues Komunal për Kthim ka mbajtur 1 takim gjatë këtij gjashtë mujori të vitit 2016, në të cilin takim është marr konkluzion verifikimi dhe vlerësimi i Komisionit profesional për ndërtimin/renovimin e shtëpisë së Dejan Kostičit nga Bërnica e Poshtme. Çdo kërkesë Zyra e procedon në Nëngrupin Punues Komunal për Kthim, që të shqyrtojë rastet përkatëse.

#### **4. Projektet infrastrukturore**

Në ditën e parë të punës më 05.01.2016 janë proceduar zyrtarisht të protokolluara projektet për investime kapitale për komunitetet jo-shumicë për vitin 2016 dhe janë dorëzuar, si vijon:

Në Drejtorinë e Shërbimeve Publike:

1. Pastrimi dhe rrethimi i varrezave myslimane në Bardhosh,
2. Pastrimi dhe rrethimi i varrezave serbe në Matiçan,
3. Ndërtimi i rrethojës së Kishës në Bërnice të Poshtme me themel betoni,
4. Ndriçimi i shtatë rrugicave në Bardhosh dhe ndriçimi i rrugës në Bërnice të Epërme prej shkollës deri tek kroi i Milevcit,
5. Vendosja e zebrave dhe shportave të mbeturinave,

Komiteti për Komunitete dhe Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim për vitin 2016 kanë proceduar në Drejtorinë e Infrastrukturës, projektet si në vijim:

Në Drejtorinë e Infrastrukturës:

6. Ndërtimi i trotuarit në rrugën kryesore në Bërnice të Poshtme në njërin krah me gjatësi prej 2.5 km,
7. Asfaltimi i rrugëve dytësore në Bërnice të Poshtme me gjatësi prej 1.5 km,
8. Asfaltimi i rrugës prej kanalit të Ibër-Lepencit deri tek varrezat në Bardhosh,
9. Shtrimi me kubëza i parkingut të Kishës "Sveti Nikola" në Prishtinë.

Është rekomanduar që projektet që ndërlidhen me Drejtorinë e Shërbimeve Publike të realizohen me buxhetin e Zyrës, ndërsa projektet për asfaltim të rrugëve nga Drejtoria e Infrastrukturës me buxhetin përkatës. Projektet e dorëzuara kanë marrë miratimin e Komitetit për Komunitete.

Pesë projekteve të para të dorëzuara në Drejtorinë e Shërbimeve Publike u janë kryer paramasat nga inxhinierët e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe janë në procedimin përfundimtar. Projektet tjera në Drejtorinë e Infrastrukturës pritet të kryhen gjatë pjesës së dytë të vitit.

Projektet kanë mbështetjen e plotë të Zyrës dhe të Komitetit për Komunitete, nëse plotësohen të gjitha kushtet e parapara në planet rregullative urbane dhe planin afatgjatë të zhvillimit të tyre infrastrukturor.

## 5. Projekte tjera

Gjatë këtij gjashtë-mujori, Zyra në bashkëpunimin me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorinë e Administratës ka identifikuar projekte të realizueshme për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas. Në vazhdimësi këto projekte janë të natyrës kulturore, edukative dhe sportive, e që do të ketë kërkesa të vazhdueshme nga komunitetet e përmendura për subvencionim të projekteve të tilla.

Projekte të realizuara:

1. Artikuj shkollor për nxënësit e komuniteteve RAE
2. Artikuj higjienik-sanitar për nxënësit e komuniteteve RAE
3. Muaji i regjistrimit civil falas për komunitetet RAE (15 Qershor – 31 Korrik)
4. Dita e Flamurit Ashkali (15 Shkurti)
5. Dita ndërkombëtare e Romëve (8 Prilli)
6. Dita ndërkombëtare e Fëmijëve (1 Qershori)
7. Dita e Egjiptianëve në Kosovë (24 Qershori)

Në procedim:

1. Projekti „Një art ndryshe“,
2. Projekti „Multi-kulti“,
3. Projektet për pajisje me instrumente vokale muzikore.

## **6. Riintegrimi i personave të riatdhesuar**

Procesi i riintegrimit të personave të riatdhesuar është një proces shumë i rëndësishëm në përmbushjen e kriterëve që ndërlidhen me integrimet europiane dhe liberalizimin e vizave, e cila parashihet edhe në kornizën ligjore dhe strategjike të integritimeve europiane. Në mbledhjen e muajit Maj të Kuvendit Komunal është miratuar Plani i Veprimit Lokal për riintegrimin e personave të riatdhesuar në Komunën e Prishtinës.

Gjatë këtij gjashtë-mujori në Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim janë paraqitur treqindpesëmbëdhjetë (315) të riatdhesuar. Të gjithë janë referuar në plotësimin e kriterëve përkatëse të përcaktuar në Rregulloren për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të riintegrimit nr. 04/2016.

Kjo Rregullore 04/2016 për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të riintegrimit nuk i ka fokusuar përfitimet emergjente si aspektin kryesor dhe riintegrues të një rasti të caktuar dhe për këtë nuk ka ndryshuar as kriterin e datës (28 Korrik 2010), por është zgjeruar në ofrimin e shërbimeve të aspektit arsimor, punësimit, praktikës në punë, aftësimin profesional dhe plan-biznesit.

Mirëpo, rastet të cilat kanë jetuar më pak se 1 vit jashtë Kosovës dhe që nuk janë raste të cënueshme - janë pjesa më e madhe që kanë emigruar në valën e fundit. Pikërisht, këto do të jenë rastet për të cilat nuk mund të hynë në kuadër të përfitimeve emergjente, apo trajtimit si rast i cënueshëm nëse nuk ka jetuar së paku 1 vit jashtë Kosovës.

Gjatë gjashtë-mujorit të parë të vitit 2016, Komisioni Komunal për Riintegrim ka zhvilluar 4 takime, në të cilat janë shqyrtuar dy (2) kërkesa të personave të riatdhesuar për riintegrimin e tyre të qëndrueshëm.

## **7. Takimet e Komitetit për Komunitete**

Gjatë gjashtë-mujorit të parë të vitit 2016 Zyra ka marrë pjesë në 6 takime të Komitetit për Komunitete, në të cilat janë shqyrtuar këto çështje: zbatimi i planit të punës, shqyrtimi i raportit të punës së ZKKK-së për çdo muaj, bashkëpunimi me drejtorinë dhe organet komunale, procedimi i rasteve në gjendje të rëndë sociale ekonomike, objektivat e përbashkëta të kthimit. Janë zhvilluar vizita në insitucionet shkollore me nxënës të komuniteteve joshumicë. Komiteti për Komunitete luan një rol të rëndësishëm përmes këshillave dhe sugjerimeve në punët dhe projektet e komuniteteve joshumicë.

## **8. Takimet në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi**

Gjatë gjashtë-mujorit të parë të vitit 2016 Zyra ka marrë pjesë në 2 takime të këtij Këshilli. Në çdo takim janë adresuar çështjet kyçe dhe incidentet konkrete, duke raportuar Policia e Kosovës me statistikat zyrtare. Gjatë këtij gjashtë mujori gjendja e sigurisë është e kënaqshme dhe nuk ka pasur incidente të natyrës etnike, duke u bazuar në raportimet e Policisë së Kosovës në KKSB.

Në takimet e radhës së këtij Këshilli do të raportohet si informatë nga Zyra riintegrimi i personave të riatdhesuar në Komunën e Prishtinës.

## **9. Takimet me Ministrinë e Punëve të Brendshme**

Gjatë këtij gjashtë-mujori Zyra ka marrë pjesë në 7 takime me MPB, në të cilat janë shqyrtuar këto çështje:

- Politika qeveritare për riintegrimin e personave të riatdhesuar,
- Miratimi i Rregullores për riintegrimin e personave të riatdhesuar,
- Kriteret për përfitim nga programi për riintegrimin e personave të riatdhesuar,
- Themelimi i plan-bizneseve nga personat e riatdhesuar,
- Sfidat e ZKKK-ve në procesin e riintegrit, përkatësisht të monitorimit të plan-bizneseve,
- Obligimet e Komunave që dalin nga korniza ligjore dhe strategjike për riintegrimin e personave të riatdhesuar.

## **10. Takimet me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim**

Gjatë këtij gjashtë-mujori Zyra ka marrë pjesë në 3 takime me MKK, me ç'rast është informuar me projektet e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim në nivelin lokal, procesin e kthimit, procedimin e kërkesave për ndihmë, funksionimin e Nëngrupit dhe Grupit Punues Komunal për Kthim dhe çështje tjera koordinuese.

Në këto takime u konstaua se procesi i kthimit është proces me rëndësi në përmbushjen e obligimeve ligjore dhe strategjike. Veçanërisht procesi i ndërtimit të shtëpive ka efektin e vet, duke ditur se ka kërkesa për ndërtim që janë dorëzuar prej disa vitesh.

## **11. Takimet me KFOR-in dhe organizatat ndërkombëtare**

Gjatë këtij gjashtë-mujori të vitit 2016 janë zhvilluar 2 takime me KFOR-in. Bashkëpunimi dhe informacionet e përgjithshme për projektet e Zyrës ishin ndër temat kryesore. Realizimi i projekteve subvencionuese dhe humanitare nga KFOR-i është kthyer në traditë të përfitimeve të projekteve nga institucionet shkollore.

Me organizatat ndërkombëtare si OSBE, UNDP, UNHCR, KAAD kemi zhvilluar takime të natyrës organizative dhe formularëve-pyetësorë që i kanë dërguar për çështjet e ndryshme të Zyrës. Me UNDP vazhdon projekti i subvencionimit në page për personat e riintegruar dhe kemi procedim të dyanshëm të informacioneve. Gjithsesi organizatat ndërkombëtare me këshillat dhe sugjerimet e tyre përbëjnë një mekanizëm të rëndësishëm në adresimin e çështjeve të ndryshme dhe bashkëpunimit me Zyrën.

## **12. Seminare**

Gjatë këtij gjashtë-mujori janë mbajtur disa seminare, të cilat ndërlidhen me punën e Zyrës dhe ngritjen e kapaciteteve njerëzore. Seminaret e tilla janë organizuar nga institucionet qeveritare dhe nga organizatat ndërkombëtare që merren me çështje të ndryshme në kuadër të mandatit të Zyrës. Disa prej seminareve janë, si vijon:

- Koordinimi institucional në mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje organizuar nga CLARD – Qendra për ndihmë juridike dhe zhvillim regional më 04.02.2016,
- Publikimi i raportit të OSBE-së mbi vlerësimin e të drejtave të komuniteteve, organizuar nga OSBE, më 23.03.2016,
- Parandalimi i radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, organizuar nga Ekipi Veprues për Siguri në Bashkësi, më 06.04.2016,
- Procesi i shpronësimit të pronës së paluajtshme, organizuar nga OSBE, më 17.05.2016,

### **13. Përmbyllje**

Zyra për Komunitete dhe Kthim i ka kushtuar rëndësi të veçantë kornizës ligjore dhe strategjike për respektimin e plotë të të drejtave të komuniteteve.

Komunitetet joshumicë kanë pasur qasje të mira në shërbimet publike në të gjitha organet komunale. Koordinimi me drejtoritë komunale është i kënaqshëm në procedimin e projekteve të investimeve kapitale dhe çështjeve të tjera. Mirëpo mbetet problematike vonesat që ndërliken me procedurat e prokurimit, të cilat zgjasin me muaj derisa fillon të implementohen projektet e investimeve kapitale, të cilat procedura po ndikojnë që projektet të barten në vitin vijues.

Sfidë e mëtejshme e Zyrës/Komunës mbetet strehimi i riintegrit të personave të riatdhesuar që plotësojnë kriteret për përfitim strehimi, duke ditur se me Rregulloren 04/2016, strehimi mbetet një çështje që duhet ta zgjidhë Komuna duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin për Financimin e programeve të Veçanta të Banimit.

Çështja më problematike e cila ka shoqëruar vazhdimisht procesin e riintegrit ka qenë dhe është çështja e strehimit. Si Komunë nuk kemi Qendër Strehimore Kolektive apo njësi banesore të cilat do të mund të shfrytëzoheshin nga Komuna për çështje të kësaj natyre. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale duhet ndërmarrë të gjitha veprimet në rastet e strehimit të rasteve të caktuara.

**Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim**